

# PERIODIKU BANKAR

VËSHTRIM MBI SEKTORIN  
FINANCIAR TË KOSOVËS



## FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE

# PERIODIKU BANKAR



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

 Banka Ekonomike



 BPB

 iSBANK

 NLB Banka

 ProCredit Bank

 Raiffeisen  
BANK

 TEB  
BNP PARIBAS JOINT VENTURE

 ZiraatBank

PËRGATITUR NGA:

DR. SC. PETRIT BALIJA,  
Kryeredaktor

KRESHNIK KOSUMI,  
Redaktor

MIRANDA RUGOVAJ  
Koordinatore

MITHAT SEJDIU  
Dizajn

SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS

DATA E PUBLIKIMIT,  
Nëntor 2016



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION

Deklarata e autorësisë: Materiali në këtë publikim ka të drejta autoriale. Kopjimi apo përdorimi i një pjese apo i tërë publikimit pa leje apo pa shënuar burimin e informacionit mund të konsiderohet shkelje e ligjeve në fuqi.

# FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE

## PËRMBAJTJA

### PJESA I

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore 1 - 4

### PJESA II

Indikatorët kryesorë të industrisë bankare të paraqitura në numra dhe figura 5-6

Struktura e aseteve 6-8

Struktura e detyrimeve 8-11

Të hyrat dhe shpenzimet 11-11

Norma efektive e interesit në kredi dhe depozita 11-12

Kreditë jo-performuese 12-13

### PJESA III

Lajme nga industria bankare dhe ekonomia 14-18

# I. FONDI KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE LEHTËSON QASJEN E NMVM-VE NË FINANCA

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) është institucion vendor, i pavarur, i qëndrueshëm që u ofron garanci kreditore institucioneve financiare, për të mbuluar deri në 50% të rrezikut të kredive për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM). FKGK-ja është krijuar për të lehtësuar lehtësuar qasjen në financa për NMVM-të, duke mundësuar kështu krijimin e vendeve të reja të punës, rritjen e prodhimitarisë vendore, rritjen e vlerave, përmirësimin e bilancit tregtar, si dhe avancimin e mundësive për sektorët ekonomikë më pak të shërbyer. FKGK-ja do të zgjerojë fushëveprimin e shërbimeve financiare dhe produkteve kreditore.

Për të kuptuar më mirë ndikimin ekonomik dhe nevojën e krijimit të këtij fondi, së pari të analizojmë shkurt gjendjen ekonomike, qasjen e NMVM-ve në financa, si dhe sektorin financiar në Kosovë. Ekonomia e Kosovës ka shënuar përparim të konsiderueshëm në tranzicionin e saj drejt ekonomisë së tregut dhe ruajtjes së stabilitetit ekonomik, por mbetet tejte e varur nga ndihmat e donatorëve ndërkombëtare si dhe dërgesat nga diaspora. Sipas Administratës Tatimore të Kosovës (ATK), në dhjetor të vitit 2014 të regjistruara kanë qenë 52,380 ndërmarrje afariste të sektorit privat. Bazuar në rregulloret e qeverisë së Kosovës, ndërmarrjet afariste kategorizohen në: ndërmarrës individualë, mikro-ndërmarrje (deri në 9 punëtorë); biznese të vogla (10 – 49 punëtorë); biznese të mesme (50 – 249 punëtorë); si dhe biznese të mëdha (250 a më shumë punëtorë).

Rreth 99% e ndërmarrjeve afariste të Kosovës janë ndërmarrje mikro, të vogla ose të mesme (NMVM), të cilat paraqesin rreth 80% të punësimit. Vlerësohet

që NMVM-të përfaqësojnë rreth 50 - 60% të BPV-së së Kosovës. Në vitin 2014, tregtia me shumicë dhe pakicë ka qenë sektori më i madh (me 43% të të gjitha ndërmarrjeve afariste të sektorit privat), i cili ofron 33% të vendeve të punës. Ndërsa sektorët me rritjen më të shpejtë gjatë viteve 2010-2013, në kuptimin e numrit të ndërmarrjeve dhe të punësimit, qenë ndërtimtaria dhe shërbimet e biznesit. Numri i ndërmarrjeve të themeluara rishtas është rritur çdo vit në periudhën 2010-2013, por numri i mbylljeve (çregjistrimeve) gjithashtu është rritur – një indikator se sa me rrezik janë bizneset e reja. Megjithatë, sipas të dhënave në ATK, kontributi në punësime të reja nga kompanitë e reja si dhe NMVM-të në zgjerim është shumë më i madh sesa vendet e punës të humbura për shkak të dështimit të bizneseve.

Aktualisht, shumica e NMVM-ve kosovare nuk shërbehen aq mirë nga sistemi financiar. Kjo sidomos vlen për NMVM-të e reja, NMVM-të me pronare gratë, si dhe NMVM-të në bujqësi. Numri i përgjithshëm i institucioneve financiare në Kosovë përfshin 10 banka komerciale, 18 kompani sigurimesh, 13 institucione mikro-financiare, si dhe 6 institucione financiare jo-bankare. Institucionet financiare i shohin NMVM-të si me rrezik dhe të shtrenjta për t'iu dhënë kredi, si dhe shpesh vendosin kritere mjaft të rënda kolaterale për NMVM-të kredimarrëse (pjesërisht për shkak të rrezikut si dhe vështirësive në përmbarrimin e kontratave kreditore dhe kthimin e mjaftueshëm të mjeteve). Kreditë joperformuese për NMVM-të janë më të larta sesa ato tek korporatat dhe kredimarrësit individualë konsumatorë. Shumica e NMVM-ve nuk kanë fare apo kanë pak pronë të paluajtshme për kolateral. Procedurat përmbarrimore të kontratave në

Kosovë, duke përfshirë edhe konfiskimin e kolateralit, gjithashtu kanë qenë joefikase, kanë zgjatur në kohë, si dhe ishin të shtrenjta, edhe pse ka përmirësime me implementimin e sistemit të Përmbaruesve Privatë prej mesit të vitit 2014.

Qasja joadekuate në financa nga NMVM-të gjithashtu mund t'i atribuohet edhe vetë huamarrësve. Për shembull, NMVM-të duhet të përmirësojnë planet e tyre të biznesit dhe pasqyrat financiare, të raportojnë shitjet e tyre, të regjistrojnë punëtorët, të bëjnë transaksionet e tyre përmes bankave, të përmirësojnë disiplinën në kthim të kredive, si dhe të jenë më të kujdesshme në kuptimin e historisë së tyre kreditore dhe raporteve kreditore. Në anën tjetër, bankat kosovare kanë politika mjaft konzervatore të kreditimit, duke përfshirë kërkesat për kolateral të gjerë të aseteve të paluajtshme dhe të luajtshme për mbështetjen e pjesës më të madhe të kredive. Si pasojë, shumë NMVM me potencial të madh të rritjes nuk mund të sigurojnë financimin që iu duhet për t'u zgjeruar dhe për të rritur punësimin.

Gjashtë banka në Kosovë kanë përvojë në punën me garanci të portofolit kreditor, duke përfshirë dhjetë instrumente garancish të portofolit kreditor nga Autoriteti Kreditor për Zhvillim nga USAID-i (DCA). Instrumentet deri më sot janë fokusuar tek bujqësia dhe NMVM-të më të reja se tri vjet. Instrumentet e garancive për bujqësi janë shfrytëzuar mirë, duke inkurajuar bankat që të kreditojnë më shumë atë sektor. DCA-ja e USAID-it ka ofruar garanci të portofolit kreditor (GPK) për bankat në Kosovë, me mbulim garancie për kredi deri në 40.4 milionë dollarë. Të gjitha garancitë nga DCA-ja janë për 50% të kryegjësë së kredive që jepen nga bankat përfituese, që do të thotë se shuma totale arrin në 80.8 milionë dollarë, me shfrytëzimin e plotë. Arsyeshmëria themelore e instrumenteve GPK të DCA-së është që të inkurajohen bankat të japin kredi për kategori popullate, kredimarrës, sektorë, rajone, etj., të cilat ndryshe nuk do t'i jepnin. Ekzistojnë

edhe disa programe të garancive kreditore nga UNDP, Fondi Evropian për Investime dhe SPARK. Të gjitha këto programe janë mjaft të dobishme dhe demonstronë që garancitë kreditore mund të rrisin qasjen në financa në Kosovë. Megjithatë, të gjitha këto programe kanë periudhë kohore të caktuar, si dhe një kufi maksimal kreditimi, pra nuk janë të përhershme dhe të ripërtëritshme. **Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) është institucion i Kosovës që do të jetë i përhershëm, i ripërtëritshëm në fonde, si dhe i qëndrueshëm.**

**FKGK-ja luan rol kyç në lehtësimin e sigurimit të financave për NMVM-të për zgjerimin e tyre.** Me zvogëlimin e rrezikut të kredimarrjes për NMVM-të, Fondi inkurajon institucionet financiare të regjistruara që të japin më shumë kredi për më shumë NMVM, të rrisin shumat e kredive, të zgjerojnë produktet dhe shërbimet në dispozicion të NMVM-ve, si dhe të lehtësojnë kushtet e afatet për kredimarrje. FKGK-ja do të ndihmojë institucionet financiare që t'i japin kredi NMVM-ve që përndryshe nuk do të mund të arrinin të kualifikoheshin për të marrë kredinë, ose nëse kanë tashmë kredi, por nuk do të kualifikoheshin për të marrë financim shtesë për rritjen e tyre. Pengesat që FKGK-ja ndihmon të tejkalohen janë edhe mungesa e kolateralit adekuat të NMVM-ve ose mungesa e regjistrimit historik të kredive dhe historisë së tyre. USAID EMPOWER Përkrahje për Kredi si program vlerëson që ka rreth 600 milionë dollarë likuiditet të tepërt në sistemin bankar të Kosovës. Nëse këto fonde do t'i kreditoreshin NMVM-ve, do të kishte rritje të konsiderueshme në prodhimtarinë vendore, zëvendësimin e importeve si dhe në punësim. Për t'i shtuar kësaj, programi USAID EMPOWER Përkrahje për Kredi kalkulon që financimi i munguar për NMVM në Kosovë është rreth 870 milionë dollarë, pra, instrumenti si FKGK është tejet i nevojshëm.

**Fondi Kosovar për Garanci Kreditore u themeluar në janar të vitit 2016** me Ligjin për Themelimin e Fondit Kosovar për Garanci Kreditore. FKGK-

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) lëshoi garancinë e parë kreditore për kredi për NMVM-të. Ekspozimi total i kredive arriti në **1,670,000 Euro** me qëllimin që këto të përdoren në blerje të makinerisë prodhuese, pajisjeve bujqësore, si dhe investim për efikasitet të energjisë.

ja synon të përkrahë sektorin privat në Kosovë, me rritjen e qasjes në financa për NMVM-të, duke krijuar kështu vende pune, duke rritur prodhimtarinë vendore, duke përmirësuar bilancin tregtar, si dhe duke zgjeruar mundësitë për sektorë ekonomikë më pak të shërbyer. Ligji për themelimin e FKGK-së ishte iniciativë e Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, mbështetur nga USAID në Kosovë, përmes Programit USAID EMPOWER Përkrahje për Kredi (ECS). Ligji ka hyrë në fuqi më 23 janar 2016.

FKGK-ja do të operojë duke lëshuar garanci të pjesëshme të kredive për deri në 50% për kredi investuese apo për kapital pune nga institucionet e regjistruara financiare (IRF) për NMVM-të. Bizneset do të aplikojnë për kredi, në pajtim me kërkesat dhe procedurat e institucionit përkatës financiar. Janë institucionet financiare ato që aplikojnë për garanci kreditore. IRF-të gjejnë vetë klientët, bëjnë procedurat e shqyrtimit dhe analizës, strukturojnë kreditë, si dhe monitorojnë e inkasojnë pagesat e kredive. IRF-të duhet të vendosin se cilat kredi do t'i dorëzojnë tek FKGK-ja për mbulesë me garanci, si dhe të përcaktojnë përqindjen e kryegjësë që do të mbulohet me garanci, deri në maksimumin prej 50%. IRF-të pastaj bëjnë vetë disbursimin e kredive dhe përcaktojnë kushtet dhe afatet e kredive. Pritet që me garanci, IRF-të të jenë në gjendje të rrisin kredidhënien e tyre për NMVM-të, si dhe të lehtësojnë kushtet dhe afatet e kredive me kohë.

Parametrat për NMVM-të e kualifikuara për financim nën garanci janë, por pa u kufizuar në këto:

- NMVM-të me më pak se 250 punëtorë

- NMVM-të që janë të kualifikueshme, por që nuk kanë kolateralin e mjaftueshëm apo/dhe historinë kreditore;
- NMVM-të që kërkojnë financim afatgjatë;
- NMVM-të që mund të rrisin prodhimtarinë vendore dhe të zvogëlojnë importet dhe/ose të rrisin eksportet;
- Grupet më pak të favorizuara ekonomike, si NMVM-të në pronësi të grave, të pakicave dhe të ndërmarrësve;
- NMVM-të që do të krijojnë vende të reja pune;

Përshkrimi i shërbimeve

- Garancitë do të ofrohen për deri në 50% të kryegjësë së kredive për NMVM-të
- Vetëm kreditë e reja mund të kualifikohen për garanci. Lëshimi i garancive për mbulimin e rifinancimit apo ristrukturimin e kredive normalisht nuk lejohen, pasi që programi është synuar të ofrojë në dispozicion financime të reja për NMVM-të, e jo të ndihmojë institucionet financiare me kreditë e tyre problematike
- Garancitë lëshohen vetëm për kryegjënë. Ato nuk mbulojnë kamatat apo shumat tjera që duhen paguar, apo shpenzimet tjera të bëra nga kredidhënësi;
- Institucioni financiar kredidhënës aplikon kriteret e veta të rregullta të aprovimit të kredive dhe përcakton kushtet dhe afatet e kredisë
- Kreditë e reja për klientë ekzistues mund të kualifikohen për mbulim me garanci
- Kreditë afatgjate, investuese (për blerje të makinerisë, pajisjeve, teknologjisë dhe pronës së paluajtshme në lidhje me operacionet afariste, si financimi i hapësirave afariste, p.sh. reparte fabrike), si dhe kreditë për qëllime të kapitalit të punës, mund të kualifikohen për mbulim me garanci

**Institucionet financiare të regjistruara** në Fondin Kosovar për Garanci Kreditore janë: Banka Ekonomike, Banka për Biznes, NLB Banka, Procredit Bank, dhe Raiffeisen Bank. Banka Ekonomike



ende nuk e ka nënshkruar zyrtarisht marrëveshjen e garancisë. Katër bankat tjera kanë nënshkruar marrëveshjen dhe kanë qasje në sistemin informativ të menaxhimit të FKGK-së. Procredit Banka është banka e parë që ka shfrytëzuar garancitë kreditore të FKGK-së, e përcjellur nga Banka për Biznes.

**Kapitalizimi.** Përpjekjet për kapitalizimin e FKGK-së janë në vazhdim e sipër, me zotimet kontribuuese nga Qeveria e Kosovës, përmes Ministrisë së Tregtisë dhe Industrisë, si dhe Agjencia Amerikane për Zhvillim Ndërkombëtar (USAID), Banka Zhvillimore KfW, si dhe Agjencia Suedeze për Bashkëpunim dhe Zhvillim Ndërkombëtar – SIDA. Përveç këtyre, përmes programit USAID EMPOWER Përkrahje për Kredi, USAID ka angazhuar 4.7 milionë dollarë për ndihmë teknike, trajnime dhe shpenzimet operative fillestare të FKGK-së.

**Menaxhimi dhe organizimi.** Fondi Kosovar për Garanci Kreditore qeveriset nga Bordi i Drejtorëve, që përbëhet nga shtatë (7) anëtarë:

- A. Një (1) anëtar ex-officio zgjedhur nga Ministria e Tregtisë dhe Industrisë
- B. Një (1) anëtar ex-officio zgjedhur nga Ministria e Financave
- C. Katër (4) anëtarë të zgjedhur nga donatorët, si dhe
- D. Drejtori Menaxhues i FKGK-së (gjithashtu anëtar ex-officio)

FKGK-ja do të operojë si subjekt i pavarur pas përfundimit të Programit USAID EMPOWER Përkrahje për Kredi (ECS). Ai do të qeveriset nga Bordi i Drejtorëve, si dhe do t'i raportojë Bankës Qendrore të Kosovës.



## II. INDIKATORËT KRYESORË TË INDUSTRIËS BANKARE

### Struktura e asetëve

**STRUKTURA E ASETEVE TË INDUSTRIËS BANKARE (2010-2016)**  
(milion euro)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Gu-16
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	307.0	331.5	425.7	463.3	447.1	491.2	458.7
Bilanci me bankat komerciale	439.1	329.5	287.9	339.9	390.8	316.0	364.7
Letrat me vlerë	173.4	202.0	256.6	354.5	383.8	473.3	435.8
Kreditë dhe lizingu	1,458.7	1,698.1	1,763.4	1,805.8	1,882.3	2,019.5	2,168.5
Asetet fikse	44.0	47.4	57.7	55.5	53.7	57.0	56.6
Asetet tjera	32.9	41.3	38.1	40.3	28.8	29.5	34.6
<b>Gjithsej Asete</b>	<b>2,455.1</b>	<b>2,649.7</b>	<b>2,829.3</b>	<b>3,059.3</b>	<b>3,186.6</b>	<b>3,385.3</b>	<b>3,518.9</b>

Tab. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

**PËRBËRJA E STRUKTURES SË ASETEVE TË INDUSTRIËS BANKARE (2010 -2016)**  
(milion euro)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Gu-16
Paraja e gatshme dhe bilanci me BQK	12.5%	12.5%	15.0%	15.1%	14.0%	14.5%	13.0%
Bilanci me bankat komerciale	17.9%	12.4%	10.2%	11.1%	12.3%	9.3%	10.4%
Letrat me vlerë	7.1%	7.6%	9.1%	11.6%	12.0%	14.0%	12.4%
Kreditë dhe lizingu	59.4%	64.1%	62.3%	59.0%	59.1%	59.6%	61.6%
Asetet fikse	1.8%	1.8%	2.0%	1.8%	1.7%	1.7%	1.6%
Asetet tjera	1.3%	1.6%	1.3%	1.3%	0.9%	0.9%	1.0%
<b>Gjithsej</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>

Tab. 2 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese




Fig. 1 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese



KREDITË SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (2010 - 2016)											
(milion euro)											
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restaurantet	Tregti tjetër	Shërbime financiare	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	38.2	14.6	127.6	18.0	109.1	521.2	39.5	18.9	22.0	113.6	1,022.8
2011	40.5	17.2	136.7	14.5	116.3	606.2	39.9	23.4	55.0	99.9	1,149.5
2012	43.6	16.2	133.1	15.9	125.2	635.3	38.8	22.7	54.5	108.8	1,194.2
2013	45.8	20.1	131.7	20.8	118.7	640.6	49.2	19.1	68.8	102.6	1,217.4
2014	49.8	19.7	153.0	20.3	107.0	674.5	51.4	18.1	60.6	102.0	1,256.4
2015	59.9	19.2	164.1	17.8	99.5	683.0	50.7	21.3	94.0	123.8	1,333.4
Gu-2016	57.6	27.1	164.3	20.2	101.8	703.7	45.7	21.7	100.8	147.4	1,390.3

Tab. 3 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave të tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik

PJESËMARRJA E KREDIVE SIPAS AKTIVITETIT EKONOMIK (2010-2016)											
Përshkrimi	Bujqësia	Minierat	Prodhimi	Energjetika	Ndërtimtaria	Tregtia	Hotelet & Restaurantet	Tregti tjetër	Shërbime financiare	Shërbime tjera	Gjithsej
2010	3.7%	1.4%	12.5%	1.8%	10.7%	51.0%	3.9%	1.9%	2.2%	11.1%	100.0%
2011	3.5%	1.5%	11.9%	1.3%	10.1%	52.7%	3.5%	2.0%	4.8%	8.7%	100.0%
2012	3.7%	1.4%	11.1%	1.3%	10.5%	53.2%	3.2%	1.9%	4.6%	9.1%	100.0%
2013	3.8%	1.7%	10.8%	1.7%	9.8%	52.6%	4.0%	1.6%	5.6%	8.4%	100.0%
2014	4.0%	1.6%	12.2%	1.6%	8.5%	53.7%	4.1%	1.4%	4.8%	8.1%	100.0%
2015	4.5%	1.4%	12.3%	1.3%	7.5%	51.2%	3.8%	1.6%	7.1%	9.3%	100.0%
Gu-2016	4.1%	2.0%	11.8%	1.5%	7.3%	50.6%	3.3%	1.6%	7.2%	10.6%	100.0%

Tab. 4 | Burimi: BQK – Kreditë e korporatave të tjera depozituese sipas aktivitetit ekonomik

## Struktura e detyrimeve

STRUKTURA E DETYRIMEVE TË INDUSTRIJË BANKARE (2010-2016)							
(milion euro)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Gu-16
Bilanci nga bankat tjera	70.7	40.0	6.0	16.5	31.6	43.4	76.8
Depozitat	1,936.8	2,104.0	2,279.1	2,449.0	2,537.5	2,701.4	2,797.1
Huatë tjera	23.4	30.4	18.9	13.4	14.1	17.6	18.7
Provizionet e shlyera	0.1	0.2	1.7	2.0	2.9	3.1	6.4
Detyrimet tjera	160.1	191.3	221.4	244.1	229.2	191.2	181.5
Borxhi i ndërruar	33.5	31.0	31.0	56.3	47.3	36.8	38.0
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.5	0.1	-	-	-
Mjetet vetanake	230.4	252.8	270.7	277.8	323.0	394.0	400.3
<b>Gjithsej Detyrime</b>	<b>2,455.1</b>	<b>2,649.7</b>	<b>2,829.3</b>	<b>3,059.3</b>	<b>3,185.6</b>	<b>3,387.3</b>	<b>3,518.9</b>

Tab. 5 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

## PJESËMARRJA E STRUKTURËS SË DETYRIMEVE TË INDUSTRIË BANKARE (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Gu-16
Bilanci nga bankat tjera	2.9%	1.5%	0.2%	0.5%	1.0%	1.3%	2.2%
Depozitat	78.9%	79.4%	80.6%	80.1%	79.7%	79.8%	79.5%
Huatë tjera	1.0%	1.1%	0.7%	0.4%	0.4%	0.5%	0.5%
Provizionet e shlyera	0.0%	0.0%	0.1%	0.1%	0.1%	0.1%	0.2%
Detyrimet tjera	6.5%	7.2%	7.8%	8.0%	7.2%	5.6%	5.2%
Borxhi i ndërvarur	1.4%	1.2%	1.1%	1.8%	1.5%	1.1%	1.1%
Obligimet nga pranimet e bankës	-	-	0.0%	0.0%	-	-	-
Mjetet vetanake	9.4%	9.5%	9.6%	9.1%	10.1%	11.6%	11.4%
<b>Gjithsej Detyrime</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>	<b>100.0%</b>

Tab. 6 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese




Fig.2 | Burimi: BQK – Bilanci i gjendjes së korporatave të tjera depozituese

## Të hyrat dhe shpenzimet

TË HYRAT E INDUSTRIË BANKARE (2010-2015) (milion euro)								
Periudha	Të hyrat nga interesi				Të hyrat nga jo-interesi		Të hyrat nga rivlerësimet	Totali
	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhura tjera operative		
2010	169.6	2.7	3.1	-	37.5	3.9	0.3	217.1
2011	186.3	4.1	4.2	-	41.7	3.3	0.0	239.6
2012	194.9	2.0	2.3	-	44.9	2.4	0.7	247.1
2013	192.5	1.4	2.3	2.0	45.6	3.9	1.2	249.0
2014	189.5	1.1	2.9	-	44.5	3.3	2.9	244.2
2015	180.4	0.5	4.4	0.7	47.1	4.0	1.1	238.2

Tab. 7 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese




Fig. 3 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese

**SHPENZIMET E INDUSTRIË BANKARE (2010-2015)**  
(milion euro)

Periudha	Shpenzimet e interesit			Shpenzimet e jo-interesit		Shp.të përgjithshme dhe admin.			Provizioni për taksat	Totali
	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizionet për humbjet e kredive	Shp.personelit	Shp.të përgjithshme	Shp.tjera nga jo-interesi		
2010	49.4	4.8	1.0	7.7	28.3	37.8	37.6	12.6	5.0	184.3
2011	51.3	5.6	1.5	8.5	34.8	40.7	33.5	22.9	5.3	204.1
2012	57.6	3.2	2.3	8.7	50.3	42.3	35.5	24.5	4.0	228.6
2013	58.0	2.6	3.2	9.4	46.1	42.3	35.6	22.5	3.2	223.0
2014	36.4	3.1	4.5	11.1	20.5	42.4	34.8	24.5	6.8	184.2
2015	16.7	3.8	2.1	12.0	-8.4	44.0	35.7	27.8	9.7	143.5

Tab. 8 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese




Fig. 4 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese




Fig. 5 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese

TË HYRAT E INDUSTRIË BANKARE (milion euro)									
Periudha	Të hyrat nga interesi					Të hyrat nga jo-interesi		Të hyrat nga rivlerësimet	Totali
	Gjithsej të hyra nga interesi	Kreditë	Plasmanet me banka	Letrat me vlerë	Të tjera	Tarifat dhe komisionet	Të ardhurat tjera operative		
Gu-2015	125.6	121.9	0.4	2.8	0.5	30.8	2.4	0.8	<b>159.6</b>
Gu-2016	119.5	-	-	-	-	31.3	2.4	1.8	<b>154.9</b>

Tab. 9 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese

SHPENZIMET E INDUSTRIË BANKARE (milion euro)											
Periudha	Shpenzimet e interesit				Shpenzimet e jo-interesit		Shp.të përgjithshme dhe admin.			Provizioni për taksat	Totali
	Gjithsej spenz. e interesit	Depozita	Huamarrje	Të tjera	Tarifat dhe Komisionet	Provizionet për humbjet e kredive	Shp.personelit	Shp.të përgjithshme	Shp.tjera nga jo-interesi		
Gu-2015	15.9	11.9	2.6	1.4	7.8	1.2	29.1	22.0	18.0	5.8	<b>99.9</b>
Gu-2016	11.6	-	-	-	10.7	8.3	27.9	28.3	7.8	5.2	<b>99.8</b>

Tab. 10 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese




Fig. 6 | Burimi: BQK – Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese



## Normat efektive të interesit në kredi

NORMAT EFEKTIVE TË INTERESIT NË KREDI (2010-2016)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Gu-16
Normat efektive në kredi të reja	13.97%	13.30%	12.24%	10.90%	9.29%	7.69%	7.52%
Normat efektive për korp. jofinanc.	14.11%	13.04%	12.34%	10.75%	9.56%	7.39%	6.73%
Normat efektive për ek.familjare	13.77%	13.85%	12.00%	11.33%	8.88%	8.39%	8.11%

Tab. 11 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar




Fig. 7 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar

## Normat efektive të interesit në depozita

DIFERENCA NDËRMJET NORMAVE TË INTERESIT NË KREDI DHE DEPOZITA (2010-2016)							
Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Gu-16
Norma efektive për gjithsej kreditë e reja	13.97%	13.30%	12.24%	10.90%	9.29%	7.69%	7.52%
Normat efektive për gjithsej depozitat e reja	3.38%	3.62%	3.72%	2.40%	1.11%	1.15%	1.25%
<b>Diferenca</b>	<b>10.59%</b>	<b>9.68%</b>	<b>8.52%</b>	<b>8.50%</b>	<b>8.18%</b>	<b>6.54%</b>	<b>6.27%</b>

Tab. 12 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar




Fig. 8 | Burimi: BQK – Normat e interesit në kredi për sektorin bankar

## Kreditë jo-performuese

### KREDITË JO-PERFORMUESE (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Gu-16
Vlera e kredive jo-performuese	86.1	96.8	132.3	157.1	154.4	125.2	110.6
Provizionet për humbje nga kreditë	115.0%	116.7%	112.7%	110.5%	114.4%	115.1%	121.1%

Tab. 13 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore

### KREDITË JO-PERFORMUESE (2010-2016)

Përshkrimi	2010	2011	2012	2013	2014	2015	Gu-16
Kreditë jo-performuese (%)	5.90%	5.80%	7.50%	8.70%	8.30%	6.20%	5.1%
NPL rritja/zvogëlimi (%)	51.70%	12.50%	36.60%	18.80%	-1.70%	-18.90%	-11.7%
Përqindja e rritjes kreditore	13.20%	16.40%	3.80%	2.40%	4.20%	7.30%	7.4%

Tab. 14 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore




Fig. 9 | Burimi: BQK – Raporti vjetor 2013, 2014 dhe raporti i informatave mujore

## Referencat

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Bilanci i gjendjes i korporatave tjera depozituese sipas maturitetit, gusht 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti vjetor 2013 dhe 2014, <http://bqk-kos.org/?id=102>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Raporti i informatave mujore të sistemit financiar, qershor 2015, <http://bqk-kos.org/?id=98>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në kredi të reja, gusht 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Normat efektive të interesit në depozita të reja, gusht 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Banka Qendrore e Republikës së Kosovës, Pasqyra e të ardhurave e korporatave të tjera depozituese, gusht 2016, <http://bqk-kos.org/?id=55>;

Fondi Kosovar për Garanci Kreditore, shtator 2016, <http://www.fondikgk.org/>;

Komiteti i Bazelit për Mbikqyrjen Bankare dhe Asociacioni Ndërkombëtar i Siguruesve të Depozitave, Principet Themelore për Sistemet Efektive të Sigurimit të Depozitave, nëntor 2014, <http://www.iasi.org/en/assets/File/Core%20Principles/cprevised2014nov.pdf>;

Parlamenti dhe Këshilli Evropian, Direktiva 2014/49/EU mbi Skemën e Garantimit të Depozitave, prill 2014, <http://eur-lex.europa.eu/legal-content/EN/TXT/PDF/?uri=CELEX:32014L0049&from=EN>;

## **PJESA III**

# **LAJME NGA INDUSTRIA BANKARE DHE EKONOMIA QË SHËNUAN MUAJIN SHTATOR**

## BANKA PROCREDIT NËNSHKRUAN MARRËVESHJEN ME FONDIN KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE



Banka ProCredit dhe Fondi Kosovar për Garanci Kreditore kanë nënshkruar marrëveshjen për garancinë kreditore me ç'rast banka do të përfitoj më shumë siguri kolaterali si dhe ulje të rrezikut për kreditë e lëshuara për biznese shumë të vogla, vogla dhe të mesme (NVM). Fondi Kosovar për garantim të kredive do të shfrytëzohet kryesisht në rastet e kreditimit të bizneseve për investime në kapital punes dhe implementimin e projekteve që kanë për qëllim të kontribuojnë në rritje ekonomike, rritje

të prodhimit si dhe gjenerimin e vendeve të punës duke përfshirë edhe bizneset e grave, fermerët, sipërmarrësit dhe të rinjtë. Drejtori Gjeneral i bankës ProCredit, Ilir I. Aliu, veçon rëndësinë e formimit të Fondit Kosovar për Garanci Kreditore si lajm të mirë - veçanërisht për komunitetin biznesit. “Nënshkrimi marrëveshjes së sotme po ashtu reflekton parimet dhe qëllimet e përbashkëta të dy institucioneve në promovimin e zhvillimit dhe punësimit duke i mbështetur ndërmarrjet shumë të vogla, të vogla dhe të mesme”. Proceduar e aplikimit të garancisë fillon që në momentin kur klientët i drejtohen bankës për të kërkuar shërbim kreditor. Nëse vlera e hipotekës huamarrësit të ardhshëm/ kolateralit nuk është e mjaftueshëm, ose kushte të tjera nuk janë përmbushur plotësisht, banka mund të vendosë për ta përdorur garancinë për ta lëshuar atë kredi. Vlen të ceket se bizneset nuk mund të aplikojnë direkt për garancinë në FKGK.

## NLB BANKA NËNSHKRUAN MARRËVESHJEN E GARANCISË ME FONDIN KOSOVAR PËR GARANCI KREDITORE



Prishtinë, 14 shtator 2016 – Fondi Kosovar për Garanci Kreditore (FKGK) sot nënshkroi marrëveshjen e garancisë me NLB Banka në Kosovë, gjë që i mundëson bankës të përfitojë më shumë siguri kolaterali për kreditë e lëshuara për ndërmarrjet mikro, të vogla dhe të mesme (NMVM-të). Marrëveshja mëton të ofrojë qasje më të lehtë në financa për kompanitë kosovare. Marrëveshja synon

të zgjerojë kredidhënien për bizneset kosovare, të kontribuojë në krijimin e vendeve të punës, rritjen ekonomike, si dhe në rritjen e mundësive për sektorë ekonomikë e kategori që janë shërbyer më pak, si gratë, pakicat, bujqit, ndërmarrësit dhe rinia. Cila është procedura për të përfituar nga ai? Bizneset aplikojnë për kredi në bankë si më parë, duke i kaluar të gjitha procedurat bankare. Nëse vlera e hipotekës/ kolateralit të kredimarrësit të ardhshëm nuk është e mjaftueshme, apo kushtet tjera nuk plotësohen, banka mund të vendosë që ta kualifikojë biznesin dhe ta lëshojë atë kredi, duke shfrytëzuar garancinë e FKGK-së. Bizneset nuk mund të aplikojnë tek FKGK-ja që të marrin garancinë. Ceremonia e nënshkrimit u mbajt në zyrat e FKGK-së, në rrugën Anton Çetta nr. 5A, në Prishtinë.



## PREZANTOHET LIGJI PËR PARANDALIMIN E PASTRIMIT TË PARAVE



Sot në Qeverinë e Kosovës është bërë prezantimi i Projektligjit për parandalimin e pastrimit të parave dhe luftimin e financimit të terrorizmit. Ministri Financave (MF), Avdullah Hoti, ka thënë se ky projektligj është përgatitur pas shumë diskutimeve me ekspertë të fushës, vendorë dhe ndërkombëtarë. “Implementimi i këtij ligji varet nga ne. Pastrimi i parave është fenomen global dhe nuk njeh komb”, ka thënë Hoti, raporton “Epoka e re”. (Epoka e Re, Telegrafi, Zëri, Kosova Sot, 1 shtator 2016).

## KONFIRMOHET SHTYRJA E AFATIT PËR FALJEN E BORXHEVE



Ministria e Financave do të procedojë në Kuvendin e Kosovës, amendamentin e ligjit për faljen e borxheve edhe për 6 muaj. Ministri i Financave, Avdullah Hoti tha se shtyrja e afatit duhet të bëhet përmes ligjit dhe jo me një vendim. Hoti po ashtu tha se deri sot janë falur mbi 120 milionë euro borxhe, ndërsa, nga ri-programimi i borxheve, buxheti ka inkasuar mbi 50 milionë euro. “Janë mbi 120 milionë euro deri më tani që janë falur. Shuma që pritet të falet është mbi 700 milionë euro”, ka bërë të ditur ministri Hoti. (Telegrafi, 5 shtator 2016).

## PËR 8 MUAJ ATK-JA MBLODHI 250 MILIONË EURO



Gjatë 8 muajve të parë të këtij viti Administrata Tatimore e Kosovës (ATK) ka arritur që të inkasojë të hyra 250.2 milionë euro, ose 16 për qind më shumë se e njëjta periudhë e vitit të kaluar. Ndërsa, në bazë të Ligjit për Faljen e Borxheve, ky institucion ka arritur që të inkasojë rreth 20,4 milionë, ndërsa ka falur 207 milionë euro. (Zëri, 9 shtator 2016).

## SIGURIA E DEPOZITAVE NË KOSOVË NË NIVEL TË KËNAQSHËM



Qendra për Hulumtime Strategjike dhe Sociale (STRAS), ka mbajtur sot konferencën me temë “Siguria e depozitave në Kosovë”. Ibrahim Rexhepi nga STRAS, ka thënë se për depozita pos BQK-së duhet të jetë edhe e BQK-së më krijimin e politikave adekuate, duke përfshi këtu edhe Ministrinë e Financave. “Depozitat janë faktor esencial për sistemin bankar. BQK ja është faktori më i madh

për stabilitet financiar”, ka thanë Rexhepi. Ndërsa Bedri Hamza, guvernator i BQK-së ka thënë se bankat menaxhojnë depozitat, prandaj, sipas tij, besimi i konsumatorëve ndaj tyre është primar. “BQK-ja objektivi ka sistemin efikas bankar duke përmirësuar funksion bankar në kuadër të rritjes ekonomike. Në anën tjetër ministri i Financave, Avdullah Hoti, ka deklaruar se Kosova si vend i ri, ka krijuar një sistem bankar të cilit mund t’i besohet. “Ka hapësirë për të ndjekur politika që ruajnë stabilitetin e vendit. Në masë të madhe stabiliteti në vend është ruajtur pasi shumë banka janë degë të bankave të huaja dhe punojnë me direktiva të Bankës Qendrore Evropiane. Jam i lumtur që niveli i kredive po rritet, dhe na lehtësojnë pak barrën në financimin e investimeve kapitale”, ka thënë Hoti. Ai ka deklaruar se është i pakënaqur me nivelin e depozitave. “Jam i pakënaqur me nivelin e depozita prej 2.5 miliard dhe me një kohë jo të volitshme, çfarë edhe i kufizon bankat”, ka thënë ai. (Epoka e Re, Telegrafi, 15 shtator 2016).

## QEVERIA UA MËSYN MILIONAVE TË TRUSTIT



Ligji për Fondet Pensionale do t’i nënshtrohet një procesi ndryshimesh në Kuvend, në funksion të qasjes sa më të madhe të Qeverisë në rreth 1.4

miliardë euro që Trusti i ka në menaxhim, shkruan sot Koha Ditore. Ndryshimet e para, në parim, do të votohen të enjten nga ligjvënësit. “Gjatë shqyrtimit të Projektligjit në komisionet parlamentare, Qeveria do të shtyjë amendamente, në mënyrë që paratë e Trustit të investohen në Kosovë. Qeveria synon edhe ta rrisë buxhetin me këto para”, ka thënë ky burim. Kabineti qeveritar e ka proceduar në Kuvend një projektligj që përmban disa ndryshime të Ligjit për Fondet Pensionale, por në to nuk shpërfaqen të këtylla synime të Qeverisë. (Koha Ditore, 22 shtator 2016).

## PËR TË SHPËRNDARË ASISTENCAT, POSTËS I KËRKOHET GARANCI QË PAGESAT T’I BËJË NË BANKA



Ligji për Fondet Pensionale do t’i nënshtrohet një procesi ndryshimesh në Kuvend, në funksion të qasjes sa më të madhe të Qeverisë në rreth 1.4

miliardë euro që Trusti i ka në menaxhim, shkruan sot Koha Ditore. Ndryshimet e para, në parim, do të votohen të enjten nga ligjvënësit. “Gjatë shqyrtimit të Projektligjit në komisionet parlamentare, Qeveria do të shtyjë amendamente, në mënyrë që paratë e Trustit të investohen në Kosovë. Qeveria synon edhe ta rrisë buxhetin me këto para”, ka thënë ky burim. Kabineti qeveritar e ka proceduar në Kuvend një projektligj që përmban disa ndryshime të Ligjit për Fondet Pensionale, por në to nuk shpërfaqen të këtylla synime të Qeverisë. (Koha Ditore, 22 shtator 2016).

## REFORMA FISKALE NUK NDIKOI NË ÇMIMET E KONSUMIT



Reforma fiskale nuk ka pasur ndikim në rënie të çmimeve të konsumit, ani pse ishte paraparë që të ndikojë direkt në shportën e konsumatorit, të bizneseve dhe zhvillimin ekonomik. Arsyen për mos

reflektimin e pakos së re fiskale në uljen e çmimeve të konsumit, e ka dhënë ministrja e Tregtisë dhe Industrisë, Hykmete Bajrami. Ibrahim Rexhepi, njohës i çështjeve ekonomike, thotë se bazuar në të dhënat e Agjencisë së Statistikave të Kosovës, reforma fiskale nuk ka pasur ndikim në rënie të çmimeve të konsumit. Heqja e TVSh-së dhe hyrja e pajisjeve, linjave të prodhimit dhe makinerive të ndryshme për prodhim në kufi me takse zero, ka pasur ndikim shumë pozitiv, gjë që ka ndikuar në rritjen e cilësisë së produkteve dhe rritjen e prodhimit në përgjithësi. (Telegrafi, 26 shtator 2016).

## INVESTIMET E HUAJA, DREJT PËRGJYSMIMIT



Ditë më parë, zyrtarët e Bankës Botërore të Kosovës, duke shpalosur të arriturat ekonomike në vendet e


rajonit të Evropës Juglindore, me theks të veçantë duke folur për rajonin e Ballkanit, kanë treguar qartë se vetëlavdërimet e Qeverisë së 'Isa Mustafës', që thonë se Kosova ka shënuar një rrije të investimeve të huaja, nuk qëndrojnë. BB-ja i ka demantuar të dhënat e fundit të Bankës Botërore, sipas të cilave, mësohet se Kosova ka shënuar një rënie drastike të investimeve të huaja direkte. Investimet e Huaja Direkte kanë rënë për 36 për qind në gjysmën e parë të vitit 2016. (Kosova Sot, 30 shtator 2016).



# PUBLIKIMET E SHOQATËS SË BANKAVE TË KOSOVËS

“Periodiku Bankar” është botim mujor i Shoqatës së Bankave të Kosovës duke filluar me publikimin e parë në muajin janar të vitit 2014. Publikimet mujore përmbajnë të dhëna dhe vlerësime të përgjithshme mbi sistemin financiar në Kosovë. Çdo publikim mujor trajton çështje të caktuara të sistemit financiar që për vëmendje kryesore ka sektorin bankar në Kosovë.  
[www.bankassoc-kos.com](http://www.bankassoc-kos.com).





# Qendra për Trajnime Bankare

## TRAJNIMET E PLANIFIKUARA PËR VITIN 2016:

Certifikimi Ndërkombëtar EFCB

Bazat e Pajtueshmërisë

Lidershipi dhe formimi i Ekipeve

Menaxhimi i Riskut Operacional

Menaxhimi i Porfolios së Riskut Kreditor

IFRS

Nga Zyrtar i TI në Auditor të TI

Mbikëqyrja e Stafit

Mirësjellja në Biznes



Për më shumë informata rreth regjistrimit apo programit, kontaktoni Qendrën për Trajnime Bankare në Shoqatën e Bankave të Kosovës.

038 246 171

[kbtraining@bankassoc-kos.com](mailto:kbtraining@bankassoc-kos.com)



SHOQATA E BANKAVE TË KOSOVËS  
KOSOVO BANKING ASSOCIATION